VENDIM
Nr.350, datë 10.6.2005

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK
"BOOM-BOOM"

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të kërkesës së subjektit të interesuar, si dhe të vendimit nr.339, datë 20.5.2005, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.036/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin "Boom Boom Radio TV" sh.p.k. për radion "Boom-Boom".
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 15.5.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj